

**KONTRATE SHITBLERJE E PASURISË E LUAJTSHME
(SHITJE KUOTASH)**

Sot më datë 30/09/2019 (dymijë e nentembedhjetë) palet e meposhtme redaktuan kete kontrate shitje:

PALA SHITËSE:

Z. Artur Dako, atesia Llambro, lindur me 02.04.1974 ne Vlore dhe banues në Vlore, madhor me zotësi të plotë juridike e për të vepruar mbajttese e leternjoftimit me nr personal H40402100Q në vijim e për efekt të kësaj Kontrate referuar si "Shitësi");

BLERESI:

Z. Lodovik Marku, atesia Gjergj, i lindur ne Rreshen, Mirdite, me datë 19.06.1991 dhe banues ne Rr. Don Bosko, Tirane, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar i identifikuar me leternjoftim me nr personal J10619050U.
(në vijim e për efekt të kësaj Kontrate referuar si "Blerësi");

Në vijim e për efekt të kësaj Kontrate, Shitësi dhe Blerësi do të referohen veçmas si Palë dhe së bashku si Palë.

MEQENËSE:

Shoqëria "Adriatica Brokerage" Sh.p.k (ne vijim "Shoqëria") është një shoqëri tregtare me përgjegjësi te kufizuar, e krijuar e qe funksionon ne përputhje me legjislacionin shqiptar, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare te Regjistrimit me Numër Unik Identifikimi NUIS L81931012T, të ndarë në 1 kuote dhe sikurse rezulton nga regjistrimet në Regjistrin Tregtar Shitësi zotëron.

Artur Dako zotërues e 1 kuote me 100 % te pjesemarrjes ne Kapital

Shitësi i ka njoftuar Blerësit ofertën e tij për shitjen e 100 % (njqind perqind) te kapitalit te Shoqërisë dhe Blerësi ka pranuar të blejë pjesëmarrjen e ofruar nga Shitësi në Shoqëri;


a. Në zbatim të kërkesave të Statutit të Shoqërisë dhe pas miratimit përkatës sipas Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, bashkëlidhur, Palët kanë vendosur të lidhin këtë Kontratë;

ATËHERË, duke qenë se ekzistojnë këto kushte paraprake, për të cilat Palët nuk kanë pretendime apo kundërshtime, Palët bien dakord për sa më poshtë vijon:

Neni 1 Objekti

1.1. Nëpërmjet kësaj Kontrate Shitësi i shet Blerësit 100 % (njqind perqind) te kapitalit te Shoqërisë dhe konkretisht:
100 % (njqind perqind) e barazvlefshme me nje kuote per **Z. Lodovik Marku**

Blerësi blen pjesëmarrjen e mësipërme nga Shitësi.



Neni 2 Çmimi

Çmimi i shitjes së kuotave të 100 % të kapitalit është 10.000 (dhjetë mijë) leke të reja shumë e cila është paguar nga blerësi në favor të shitësit sipas mandatit të arketimit bashkëngjitur kësaj kontrate shitjeje.

Neni 3 Deklarimet dhe garancitë

3.1 Shitësi deklaron dhe vërteton se në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate ajo zotëron pjesëmarrjen e transferuar sipas kësaj Kontrate, dhe se nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Shitësi nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, apo dokumente të tjera ligjore, subjekt i të cilave është Shitësi.

Shitësi deklaron se ja shet blerësit kuotat e zotëruara prej tij në vlerën prej 10 000 (dhjetë mijë) leke të reja, bashkë me pjesën respektive të të drejtave dhe detyrimeve që shoqëria ka ndaj shtetit apo shoqërive të tjera apo paleve të treta.

3.2. Blerësi deklaron dhe vërteton se nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga ai nuk vjen në kundërshtim me ligjet, subjekt i të cilave është.

Blerësi deklaron se është njohur me dokumentacionin dhe me gjendjen e kontabilitetit të Shoqërisë dhe deklaron se është dakord të blejë kuotat në vlerën prej 10 000 (dhjetë mijë) leke të reja, bashkë me të gjitha të drejtat e detyrimet respektive që shoqëria ka ndaj shtetit apo shoqërive të tjera apo paleve të treta.

Neni 4 Transferimi i të drejtave


4.1. Pronësia mbi kuotat e Shoqërisë, objekt i kësaj Kontrate, kalon nga Shitësi të Blerësi menjëherë me nënshkrimin e kësaj Kontrate

4.2. Kjo Kontrate nuk është dhe në asnjë rast nuk do të interpretohet si një kontratë shitje me rezerve pronësie. Kalimi i pronësisë së kuotave të Shoqërisë në favor të Blerësit do të regjistrohet menjëherë në Qendrën Kombëtare të Biznesit në përputhje me Ligjin 9901/2008, të ndryshuar dhe Ligjin 9723/2007, të ndryshuar.

4.3. Pas nënshkrimit të kësaj Kontrate, struktura e zotërimit të kapitalit të Shoqërisë do të jetë:

- **Lodovik Marku** zotëron 1 kuotë që përben 100%(njëqind për qind) të kapitalit themeltar të shoqërisë "Adriatica Brokerage" sh.p.k.

4.4. Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Blerësi gëzon të gjitha të drejtat për të regjistruar pronësinë mbi kuotat në Regjistrin Tregtar si dhe pranë çdo institucioni tjetër sipas legjislacionit në fuqi.



Neni 5 Të ndryshme

- 5.1. Çdo kusht, klauzolë apo parashikim i kësaj Kontrate do të jetë i vlefshëm pavarësisht kushteve, klauzolave apo parashikimeve të tjera dhe vlefshmëria e një kushti, klauzole apo parashikimi nuk do të çenohet nga pavlefshmëria e një kushti, klauzole apo parashikimi tjetër.
- 5.2. Kjo Kontratë do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me dispozitat e Ligjit 9901/2008, të ndryshuar dhe Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.
- 5.3. Çdo konflikt që ka lindur si pasojë apo lidhet me këtë Kontratë do të zgjidhet në marrëveshje ndërmjet Palëve, në rast të kundërt kompetente për zgjidhjen e konflikteve është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane.
- 5.4. Kjo Kontratë hartohet në gjuhën shqipe në 3 (tre) kopje origjinale.

PALET KONTRAKTUESE

Lexuar, aprovuar dhe nënshkruar nga:

PALA SHITËSE

PALA BLERËSE

Artur Dako

Lodovik Marku

ARTUR DAKO

Lodovik Marku

